

**KOMBET E  
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen  
Penale të Personave Përgjegjës për  
Shkelje të Rënda të së Drejtës  
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera  
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej  
Vitet 1991

Lënda Nr. IT-04-84-A

Data: 19 korrik 2010

Origjinali: anglisht

**NË DHOMËN E APELIT**

**Para:** Gjykatësit Patrick Robinson, Kryegjykatës  
Gjykatësit Fausto Pocar  
Gjykatësit Liu Daqun,  
Gjykatëses Andréia Vaz  
Gjykatësit Theodor Meron

**Sekretari:** Z. John Hocking

**Urdhërtransferim:** 19 korrik 2010

**PROKURORI**

**kundër**

**Ramush HARADINAJT  
Idriz BALAJT  
Lahi BRAHIMAJT**

***KONFIDENCIAL DHE EX PARTE***

**URDHËR PËR TRANSFERIMIN E IDRIZ BALAJT**

**Zyrës së Prokurorit:**

Z. Peter Kremer  
Z. Marwan Dalal  
Zj. Elena Martin Salgado

**Avokatëve të Idriz Balajt**

Z. Gregor Guy-Smith  
Zj. Colleen Rohan

**Mbretërisë së Holandës**

**Misionit të Bashkimit Evropian  
për Shtetin e Së Drejtës në Kosovë**

**DHOMA E APELIT** e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (përkatësisht “Dhoma e Apelit” dhe “Tribunali”);

**DUKE MARRË SHËNIM** “Aktgjykimin”, e nxjerrë prej Dhomës Gjyqësore I më 3 prill 2008 në çështjen *Prokurori k. Idriz Balajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T;<sup>1</sup>

**DUKE MARRË SHËNIM** “Njoftimin për Apel të Prokurorisë (Publik me Shtojcë Konfidenciale)”, paraqitur më 2 maj 2008;

**DUKE MARRË SHËNIM** “Njoftimin për Apel në Emër të Të Akuzuarit të Tretë Lahi Brahimaj”, paraqitur më 5 maj 2008;

**DUKE MARRË SHËNIM** se seanca e apelit u zhvillua më 28 tetor 2009;

**DUKE MARRË SHËNIM** “Urdhrin për Caktimin e Datës së Shpalljes së Vendimit”, lëshuar më 2 korrik 2010, ku urdhërohej mbajtja e një seance në Sallën Gjyqësore I të mërkurën, 21 korrik 2010, në orën 9:30, gjatë së cilës do të shpallej publikisht Vendimi i Apelit;

**DUKE MARRË PARASYSH** se Dhoma e Apelit ka dhënë Vendimin e Apelit më 19 korrik 2010, në të cilin.

(a) bazuar në Nenin 25 të Statutit të Tribunalit (“Statuti”) dhe Rregullat 117 dhe 118 të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”), **MIRATOI** Pikën 1 të Apelit të Prokurorisë, me përjashtim të gjykatësit Robinson, dhe **SHFUQIZOI** Vendimi e Dhomës Gjyqësore:

(i) që shpalli të pafajshëm Ramush Haradinajn dhe Idriz Balajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (“NPK”) për kryerjen e krimeve në shtabin dhe

<sup>1</sup> *Shih Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-I, confidential and *ex parte* Order on Prosecution Motion for Judicial Request, 9 March 2005/Urdhër Konfidencial dhe *ex parte* mbi Mocionin e Prokurorisë për Letërporosi, 9 mars 2005; *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-I,

burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 28, 30, 32, dhe 34 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Katërt, me datë 16 tetor 2007 (“Aktakuza”);

(ii) që shpalli të pafajshëm Lahi Brahimajn për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për kryerjen e krimeve në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat 24, 26, 30, dhe 34 të Aktakuzës;

(iii) që liroi prej përgjegjesisë penale individuale Ramush Haradinajn, Idriz Balajn, dhe Lahi Brahimajn në lidhje me Pikat 24 dhe 34 të Aktakuzës;

(iv) që liroi prej përgjegjesisë penale individuale Lahi Brahimajn në lidhje me Pikën 26 të Aktakuzës; dhe

**URDHËROI** që Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, dhe Lahi Brahimaj të rigjykoen në lidhje me këto pika; dhe

(b) bazuar në Rregullën 64 dhe Rregullën 107 të Rregullores, **URDHËROI** marrjen në paraburgim të Ramush Haradinajt, Idriz Balajt, dhe Lahi Brahimajt dhe **UDHËZOI** Komandantin e Njësisë së Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara në Hagë që t’i mbajë në paraburgim deri në një urdhër tjetër;<sup>2</sup>

**DUKE MARRË SHËNIM** se Idriz Balaj pas shpalljes së pafajësisë së tij prej Dhomës Gjyqësore u transferua përsëri në Kosovë për të vazhduar kryerjen e dënimit të tij me 13 vjet burgim në Kosovë;<sup>3</sup>

**DUKE MARRË SHËNIM** “Njoftimin në Emër të Idriz Balajt”, dorëzuar më 9 korrik 2010 ku Idriz Balaj informon Dhomën e Apelit dhe Sekretarinë se nuk do të jetë i pranishëm në shpalljen e vendimit të apelit më 21 korrik 2010;

---

Urdhër për Mbajtje në Paraburgim, 11 mars 2005; *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerë*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Urdhër mbi Transferimin e Idriz Balajt, 3 prill 2008.

<sup>2</sup> Aktgjykim, para 377.

<sup>3</sup> *Prokurori k. Ramush Haradinajt dhe të tjerë*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Urdhër mbi Transferimin e Idriz Balajt, 3 prill 2008.

**BAZUAR NË** Nenet 18, 20, 21, 25 dhe 29 të Statutit dhe Rregullat 54, 55, 56, 57, 58, 59, 59bis dhe 107 të Rregullores;

### **DHOMA E APELIT URDHËRON SI MË POSHTË**

1. **UDHËZON DHE AUTORIZON** autoritetet kompetente të Misionit të Bashkimit Evropian për Shtetin e Së Drejtës në Kosovë (“EULEX”) të cilëve u është përcjellë ky urdhërtransferim, që të dorëzojnë pa vonesë në Tribunal

#### **IDRIZ BALAJN**

i cili akuzohet për krime të kryera në shtabin dhe burgun e UÇK-së në Jabllanicë në lidhje me Pikat e mëposhtme të Aktakuzës:

Pika 24, vrasje, trajtim mizor dhe torturim (si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës);

Pika 26, vrasje dhe trajtim mizor (si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës);

Pika 28, trajtim mizor dhe torturim (si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës);

Pika 30, vrasje, trajtim mizor dhe torturim (si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës);

Pika 32, vrasje, trajtim mizor dhe torturim (si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës); dhe

Pika 34, trajtim mizor dhe torturim (si shkelje e ligjeve dhe zakoneve të luftës).

2. **KËRKON** prej EULEX-it që ta informojë Idriz Balajn në kohën e transferimit të tij dhe në një gjuhë që ai e kupton, për të drejtat e tij të përcaktuara në Nenin 21 të Statutit dhe në Rregullat 42, 43 të Rregullores, të bashkëngjitura këtij urdhri në anglisht dhe në shqip, dhe për të drejtën e tij për të heshtur, dhe ta paralajmërojë se çdo deklaratë e tij do të shënohet dhe mund të përdoret si prove.

3. **KËRKON** prej EULEX-it, autoriteteve të Mbretërisë së Holandës (“Holanda”) dhe Sekretarit të Tribunalit (“Sekretari”) që të komunikojnë midis tyre për të mundësuar transferimin e organizuar të Idriz Balajt në NJPKB.
  - a. **KËRKON** prej EULEX-it që ta shoqërojë Idriz Balajn deri në një aeroport në Kosovë dhe ta dorëzojë në përgjegjësinë e oficerit të sigurimit të Tribunalit caktuar prej Sekretarit.
  - b. **KËRKON** prej EULEX-it që të garantojë sigurinë dhe mirëqenien personale të Idriz Balajt deri kur ai të dorëzohet në përgjegjësinë e oficerit të sigurimit të Tribunalit në aeroportin përkatës.
  - c. **UDHËZON** Sekretarin që të zbatojë procedurën e parashtruar në Rregullën 59bis të Rregullores.
  - d. **KËRKON** prej Holandës që ta marrë Idriz Balajn në dorëzim me mbërritjen e tij në Holandë dhe ta shoqërojë deri në NJPKB.
4. **KËRKON** prej autoriteteve të të gjitha shteteve nëpërmjet territorit të të cilëve mund të udhëtojë Idriz Balaj:
  - a. ta mbajnë Idriz Balajn nën ruajtje gjatë kohës që ai do të jetë në kalim në aeroport; dhe
  - b. ta arrestojnë dhe paraburgosin Idriz Balajn nëqoftëse ai orvatet të arratiset, gjatë transferimit të tij në NJPKB.
5. **KËRKON** prej Sekretarit që t’ua dorëzojë urdhërtransferimin EULEX-it dhe Holandës sa më shpejt.
6. **UDHËZON** EULEX-in dhe Holandën ta zbatojnë sa më shpejt urdhërtransferimin, dhe të informojnë Sekretarin sa më shpejt pas zbatimit të urdhërtransferimit.
7. **KËRKON** prej Sekretarit që t’ua dorëzojë urdhërtransferimin Prokurorisë dhe avokatëve të Idriz Balajt pasi Sekretari të jetë informuar se urdhërtransferimin është zbatuar.

8. **KËRKON** prej Sekretarit që shfuqizojë konfidencialitetin e urdhërtransferimit pas transferimit të Idriz Balajt në NJPKB.

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht, teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/  
Gjykatës Patrick Robinson  
Kryegjykatës

Sot, më 19 korrik 2010  
Në Hagë  
Holandë

**[Vula e Tribunalit]**